



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 2268142; Fax 042268141

Nr. 389/1 Prot

Tiranë më 16.09. 2015

V E N D I M

Nr. 97, datë 16 / 09 /2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil
Bashkia Tiranë
Njësia Administrative Nr. 9

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar); neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithëshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes të zhvilluar në Njësinë Administrative Nr. 9, Bashkia Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 50, datë 25.05.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në subjektin, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, tashmë njësi administrative e Bashkisë Tiranë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Procesi është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 389/1 prot., datë 25.05.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 389/2 prot., datë 25.05.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 389/3 prot., datë 31.07.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Ndërkohë, për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë*

31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar", ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", njësitë bashkiake, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Kreu III, "Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve", pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, "Transferimi i personelit", parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrië dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njësive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar, do t'i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, si institucioni përgjegjës në këtë rast. Ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të riorganizimit të njësive të qeverisjes vendore, janë pasqyruar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për t'u shprehur në lidhje me pretendimet dhe observacionet për projektraportin, rezulton se pranë Komisionerit nuk është paraqitur asnjë përgjigje.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Njësia Administrative Nr. 9, Bashkia Tiranë, i cili është pjesë e këtij vendimi.

2. Njësia përgjegjëse, në kushtet e riorganizimit të strukturës dhe organikës së njësive administrative, me qëllim që të respektohen kërkesat e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, të veprojë si më poshtë:
 - Të bëhet klasifikimi i saktë i pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni dhe të pasqyrohet ky proces në strukturën dhe organikën përkatëse, ku të jetë shënuar edhe kategoria e pagës për çdo pozicion pune.
 - Të rishikohen emërtesat e pozicioneve të punës, sipas Lidhjes nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Në këto rrethana, njësia përgjegjëse i lind si detyrë që emërtesat e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të njehsohen me emërtesat përkatëse të pozicioneve të punës, të përcaktuara në nenin 19, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, të sipërpërmendur, Kreu II i titulluar “Klasifikimi”, (pika 5) dhe kreu III i titulluar “Grupet e pozicioneve të punës”.
3. Njësia Përgjegjëse, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, duhet të ndryshojë të gjitha aktet e nxjerra gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, të datës 20.06.2014, të emërtuara: “Konfirmim i nëpunësit civil/nëpunës civil në periudhë prove”, në: “Akte të deklarimit të statusit të punësimit nëpunës civil/nëpunës civil në periudhë prove”, në përputhje me pikat 3 dhe 4, të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas rekomandimeve të detajuara në raportin e mbikëqyrjes.
4. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 67, pika 3, e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil për nëpunësit *****, në pozicionin “Specialist Bibloteke” dhe *****, në pozicionin “Specialist Ambjentalist”.
5. Njësia përgjegjëse, të revokojë Urdhrin nr. 1, datë 12.02.2015 “Për emërimin si specialist në mënyrë të përkohshme”, në pozicionin “Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve”, për nëpunësen *****, si një akt që vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi nuk është plotësuar në një prej mënyrave të përcaktuara në këtë akt ligjor.
Në koherencë me ndryshimet organizative të Bashkisë Tiranë, të plotësojë pozicionin e lirë, të krijuar në mënyrë të përkohshme, sipas kërkesave të nenit 23 dhe 24 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut V, pika 1, 2, 3 dhe 4 të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
6. Njësia përgjegjëse në lidhje me 3 pozicione pune, nga të cilët 2 (dy) pozicione “Specialist taksash” dhe 1 (një) pozicion “Specialist tregu”, duhet të veprojë si më poshtë:
 - Të rishikojë vlerësimin e pozicionit të tyre në raport me shërbimin civil, sipas vendit në strukturë dhe detyrave funksionale që kryejnë.

- Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist taksash*”, sipas pikës 3, të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
 - Të zgjidhë marrëdhënien e punësimit për punonjësin ***** , si punonjës që nuk plotëson kriteret e posaçme të pozicionit të punës “*Specialist taksash*”, bazuar në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, pasi nuk e ka kryer arsimin e lartë.
 - Në koherencë me ndryshimet organizative të bashkisë, të shpallë pozicionin “*Specialist taksash*”, si pozicion i lirë dhe të bëjë plotësimin e tij nëpërmjet procedurës së konkurimit, të parashikuar në nenin 23 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në bazë të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
 - Të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , si nëpunës civil në periudhë prove për pozicionin “*Specialist tregjesh*”, bazuar në pikën 4 të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
7. Njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe Departamentin e Administratës Publike, të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil.
8. Njësia përgjegjëse, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.
- Në zbatim të rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të hartohen përshkrimet e punës edhe për pozicionet që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile.
9. Të plotësohen dosjet e personelit në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në Aneksin nr. 2, “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 9, Tiranë*”.
10. Të përfshihet njësia administrative nr. 9 në planin vjetor të i pranimi në shërbimin civil, i cili miratohet sipas nenit 18 të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 108, dt. 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil*”.

11. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e konfirmimit për nëpunësit, të cilëve i ka përfunduar periudha e provës, duke vepruar në këtë mënyrë :

- Të përfundojë procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- Momenti i vlerësimit të punës duhet të llogaritet duke filluar nga data e daljes së aktit të emërimit të nëpunësit civil, për rastet kur nëpunësi ka filluar punë nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*" dhe në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, ende nuk ishte përmbushur periudha e provës (1 vit).
- Procesi i vlerësimit të punës, për punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune kontraktuale në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet të përkohë me përfundimin e periudhës së provës, që në këto raste fillon në datën 26.02.2014.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës, për të gjithë punonjësit që e përfundojnë atë sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
- Të administrohet në dosjen e personelit, rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), si dhe certifikata e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
- Procesi duhet të përfundojë me vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës, për secilin nëpunës që trajtohet sipas procedurave të mësipërme.
- Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, të përfshihet evidentimi i bazës ligjore ku mbështetet procesi, si dhe të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin, datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, të evidentohet në akt, numri dhe data e dokumentit të përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit, pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP).

12. Njësia përgjegjëse dhe subjektet përkatëse, në lidhje me 2 punonjëset ***** dhe ***** , për të cilat është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, duhet të veprojnë si më poshtë:

- Të revokohet vendimi nr. 5, datë 25.05.2015 "*Për konfirmim si nëpunës civil*" për punonjësen ***** , si një akt që ka dalë në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në kushtet kur nuk është plotësuar njëri nga elementët kryesorë ligjorë, vlerësimi i rezultateve në punë, në përputhje me Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*".

- Eprori direkt, në rastin konkret duhet të shtyjë periudhën e provës për këtë punonjëse dhe vetëm pasi të jetë bërë vlerësimi i rezultateve në punë, mund të vendoset konfirmimi ose jo i saj, në shërbimin civil.
 - Të zgjatet periudha e provës për shkak të lejes së lindjes për nëpunësen ***** , emëruar në pozicionin “*Specialist për mbrojtjen e fëmijëve*” dhe pas përfundimit të lejes, t’i garantohet cikli i detyrueshëm i trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
 - Të realizohet procesi i vlerësimit të rezultateve të saj në punë, dhe vetëm pas përfundimit të periudhës së provës, duke përjashtuar periudhën e lejes së lindjes, të vendoset për konfirmimin ose jo të saj, si nëpunës civil.
- 13.** Njësia përgjegjëse duhet të realizojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2014, duke vepruar si më poshtë:
- Të hartojë dhe të plotësojë formularët e vlerësimit të punës sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”.
 - Të nënshkruhen formularët e vlerësimit të punës nga personat përgjegjës dhe të depozitohen pranë Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë, si pjesë e dosjes personale të çdo nëpunësi civil.
- 14.** Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
- 15.** Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
- 16.** Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Tiranë; Njësia Administrative nr. 9, Tiranë; Departamenti i Administratës Publike; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA